



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI MBIKQYRES
PORTI DETAR SH.A, SHENGJIN

V E N D I M

Nr. 1 Date 23, 12, 2005


Keshilli Mbiqyres i Portit Detar Sh.A, Shengjin i miratuar me urdherin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës nr.251, date 21.12.2005, në mbledhjen e datës 23.12.2005, në prezencë të plotë të tre anëtarëve të Keshillit Mbiqyres me vota të plota:

V E N D O S I:

1. Te liroje nga detyra e drejtorit të Portit Detar Sh.A. Shengjin, Z.Fran MATAJ. Marredhenie e punës në këtë pozicion për Z.Mataj, ndërpriten në datën 23.12.2005, dhe ato financiare me dorezimin e detyrës.
2. Pas shqyrtimit të kandidatures së paraqitur për pozicionin e Drejtorit të Portit Detar Sh.A. Shengjin, miratohet kandidatura e Z. Zef GJOKA, Drejtor të Portit Detar Sh.A. Shengjin. Marredheniet e punës në këtë pozicion për Z. Gjoka, fillojnë në datën 23.12.2005. Paga mujore do të jetë 85.000 leke.
3. Sektoret përgjegjës të shoqërisë të kryejnë veprimet konform rregullave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Keshillit Mbiqyres


Shkelqim Xhaxhiu





REPUBLIKA E SHOIPËRISË
SH.A. "PORTI DETAR" SHËNGJIN
KËSHILLI MBIKQYRËS

VENDIM

Nr. 13, datë 06/11/2013

Për

Lirimin dhe emërimin në detyrë të Drejtorit të Sh.a. "Portit Detar" Shëngjin

Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen e tij të datës 06.11.2013, në mbështetje të nenit 158, pika 1 dhe 7, të nenit 167, pika 2, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të nenit 8, të ligjit nr.7926, datë 20.04.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në Shoqëri Tregtare" i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Lirimin e Z. Zef Gjoka nga detyra, Drejtor i Sh.a. "Porti Detar" Shëngjin.
2. Emërimin e Z. Gjovalin Tusha në detyrën, Drejtor i Sh.a. "Porti Detar" Shëngjin.
3. Ngarkohet Sh.a. "Porti Detar" Shëngjin, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Këshilli Mbikqyrës

Majlinda Dhuka

Milbana Treska (Tole)

Emiljano Aleks

Arac Maclu



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SH.A PORTI DETAR SHËNGJIN

Nr. ____ Prot.

Shëngjin, më 11/11/2016

VENDIM

Nr. 4, date 11/11/2016

Keshilli Mbikqyres, ne mbledhjen e tij te dates 11/11/2016, ne mbeshtetje te ligjit nr.9901, date 14.04.2008, " Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", te ndryshuar, vendimit nr.642, date 11.10.2005, te Keshillit te Ministrave " Per Keshillat Mbikqyres te Shoqerive Anonime Shteterore", te ndryshuar, Udhezimit Nr.318, date 08.04.2009, "Per emerimin, funksionimin dhe shperblimin e Keshillit Mbikqyres ne Shoqerite Anonime Shteterore", te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Siper marrjes, Statutit te Shoqerise "Porti Detar", Shengjin Sh.a, dhe relacionit te paraqitur nga Drejtori i Shoqerise:

Duke qenë se:

-Nga ana e organeve drejtuese te shoqerise, eshte pergatitur kontrata qe duhet lidhur ndermjet Administratorit te Shoqerise dhe Keshillit Mbikqyres te shoqerise.

Në mbështetje të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe Statutit te shoqërisë, Këshilli Mbikqyres i Sha Porti Detar Shengjin,

VENDOSI:

1. Te miratoje Zgjatjen e kontrates se punes ndermjet Administratorit te shoqerise dhe Keshillit Mbikqyres te shoqerise se Sha Porti Detar Shengjin, per nje periudhe 3 (tre) vjeçare.
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere dhe ngarkohet administrata e shoqerise se Sha Porti Detar Shengjin, per zbatimin e ketij vendimi.

Per Keshillin Mbikqyres:

Mimoza Dhembë Kryetare

Emiljano Aleksë Anetar

Gentian Kerë Anetar

Sekretare e Keshillit Mbikqyres
Eljona Çuka

KONTRATË

Neni 1 - Palët

Kjo marrëveshje lidhet midis sh.a "Porti Detar Shëngjin", me adresë Shëngjin - Lezhë, përfaqësuar ligjërisht në këtë marrëveshje nga Administratori z. Gjovalin Tusha dhe Këshillit Mbikqytës, me adresë Vironë, përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit z. Mimoza Shëmbi.

Neni 2 - Objekti

Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve që përfshin kjo kontratë, të cilat lindin në kuadrin e bashkëpunimit nga afër për të mirën e shoqërisë.

Neni 3 - Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet në përputhje me:

- ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- statutin e ndryshuar të shoqërisë, i miratuar me shkresën nr 7777/1 prot, datë 23.11.2011;
- rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të sh. a "Porti Detar Shëngjin", miratuar me vendimin nr. 3, datë 23.05.2012; si dhe
- vendimin nr. 13 datë 06.11.2013.

Neni 4 - Përkufizime dhe interpretime

4.1. Termat e përdorur në këtë kontratë janë në përputhje me termat e përcaktuara në Statutin e ndryshuar të shoqërisë dhe rregulloren e brendshme të shoqërisë.

4.2. Çdo kusht ose formulim i kontratës, që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Statutit të ndryshuar të shoqërisë dhe rregullores së brendshme të shoqërisë dhe në këndvështrimin e qëllimit për të cilin është lidhur kjo kontratë nga palët.

4.3. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë kontratë, aplikohen dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 5 - Kohëzgjatja

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe do të zgjasë për një periudhë kohe 3 (tre) vjeçare (me të drejtë rizgjedhje).

Neni 6 - Angazhimi i palëve

Këshilli Mbikqytës dhe Administratori, angazhohen për zbatimin e kushteve të kësaj kontrate në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet palëve për të mirën e shoqërisë, zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë konform kërkesave të Ligjit dhe të Statutit, në diskutime të hapura, duke ruajtur plotësisht fshehtësinë e informacionit, kryerjen e detyra me mirëbesim, ushtrimin e kompetencave vetëm

1

për qëllimet për të cilat janë dhënë këto kompetenca, ushtrimin e detyrave me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm, përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore, caktimin e synimeve, strategjisë dhe strukturës së shoqërisë si dhe për respektimin e ndryshimeve të herëpashershme që mund t'i bëhet kontratës, me pëlqimin paraprak të palëve.

Neni 7 - Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit

Administratori i shoqërisë në rolin e tij si administrues, përfaqësues, ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në statutin e ndryshuar të shoqërisë, i miratuar me shkresën nr 7777/1 prot, datë 23.11.2011; si dhe rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të sh. a "Porti Detar Shëngjin", miratuar me vendimin nr. 3, datë 23.05.2012.

Neni 8 - Të drejtat dhe detyrimet e Këshillit Mbikqytës

Këshilli Mbikqytës, ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në statutin e ndryshuar të shoqërisë, i miratuar me shkresën nr 7777/1 prot, datë 23.11.2011.

Neni 9 - Mënyra e njoftimit

9.1. Çdo njoftim, kërkesë ose çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve bëhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, e-mail, dhe në rastet kur komunikimi me mjetet e lartpërmendura është i pamundur, me telefon në adresat, numrat telefonikë dhe personat e kontaktit përkatës të palëve.

9.2. Secila palë është e detyruar të njoftojë palën tjetër për ndryshimet e mundshme të adresave, numrave telefonikë dhe të personave të kontaktit, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga ndryshimi i tyre.

Neni 10 - Ndryshimet e kontratës

10.1. Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me shkrim dhe me vullnetin, dhe pëlqimin e të dyjave palëve.

10.2. Çdo ndryshim, shtesë e kësaj kontrate nuk do të ketë fuqi nëse nuk është kryer me shkrim dhe nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

Neni 11 - Zgjidhja e kontratës

11.1. Palët kanë të drejtë të zgjidhin kontratën në mënyrë të njëanshme, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës që ata dëshirojnë të zgjidhin kontratën.

11.2. Personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme.

11.3. Administratori jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.

11.4. Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit Mbikqytës në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikqytës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

2

Neni 12 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

12.1. Palët respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.

12.2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.

12.3. Palët e përfshira në mosmarrëveshje duhet të bëjnë përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.

12.4. Nëse palët nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit apo për një kohë më të gjatë të miratuar nga palët, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.

12.5. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lezhë.

Neni 13 - Hyrja në fuqi

13.1. Kjo kontratë është përpiluar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban një kopje.

13.2. Kontrata pasi u lexua nga palët, u konsiderua e redaktuar sipas pëlqimit të tyre dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të lirë.

13.3. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kjo kontratë firmoset nga:

Për sh.a "PORTI DETAR SHËNGJIN"

ADMINISTRATORI

GJOVALIN TUSHA

Për KËSHILLIN MBIKQYRËS

KRYETARI

Mimoza Shëmbi



Nr 154 Prot
Dt 16.11.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

URDHËR

Nr. 136 Datë 15/11/17

16465

PËR

LIRIM ADMINISTRATORI

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe statutit të shoqërisë "Porti Detar" Shëngjin, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë, nisur nga përkeqësimi i treguesëve ekonomiko-financiar, dhe rezultati financiar në tre vitet e fundit negativ (humbja gjithsej -59,596,900 lekë);

URDHËROJ:

1. Lirimin e Z. Gjovalin Tusha, nga detyra e Administratorit të shoqërisë "Porti Detar" sha Shëngjin.
2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar "Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.
4. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR



Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr 3; Tiranë, Albania; www.financa.gov.al; info@financa.gov.al

Nr 155 Prot
Dt. 16.11.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

URDHËR

Nr. 137 Datë 15/11/17

16467

PËR

EMËRIM ADMINISTRATORI

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe statutit të shoqërisë "Porti Detar" Shëngjin, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë,

URDHËROJ:

1. Emërimin e Z.Ermal Pacaj, në detyrën e Administratorit të shoqërisë "Porti Detar" sha Shëngjin.
2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar "Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.
4. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR



Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr 3; Tiranë, Albania; www.financa.gov.al; info@financa.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
KABINETI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001

URDHËR

Nr. 48 Datë 30/10/2013

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILL MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin nr. 7926, datë 20.04.1995, "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 642, datë 11.10.2005, "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore,

URDHËROJ:

1. Lirimin nga detyra të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në Sh.A "Porti Detar" Shëngjin:
-Znj. Mimoza VOKSHI.
-Z. Mirgen LATA.
 2. Emërimin në Këshillin Mbikëqyrës të Sh.A "Porti Detar" Shëngjin:
-Znj. Majlinda DHUKA, Përfaqësuese e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
-Z. Emiljano ALEKSI, Përfaqësues i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.
 3. Në zbatim të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36, të bëhen ndryshimet përkatëse në Regjistër.
- Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Maie Haru



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

URDHËR

Nr. 34 Datë 23/6 /2014

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirim nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në sh.a " Porti Detar" Shëngjin :
 - Zj. Majlinda DHUKA
2. Emërimin si anëtarë në Këshillin Mbikëqyrës të sh.a " Porti Detar" Shëngjin :
 - Zj. Evis SHURDHA, Përfaqësuese e MZHETS.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR



Handwritten signature



REPUBLIKA E ALBANIË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SHËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

URDHËR

Nr. 8262 Datë 14/10/2016

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në "Porti Detar" SHA Shëngjin:
 - Znj. Evis Shurdha
2. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të "Porti Detar" SHA Shëngjin:
 - Z. Gentian Këri
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E ALBANIËS
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2017.

URDHËR

Nr. 472 Datë 23 / 1 /2017

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare”, i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 “ Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirim in si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të “Porti Detar ” sh.a, Shëngjin:
 - Z. Gentian KËRI përfaqësues i MZHETTS .
2. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të “Porti Detar ” sh.a, Shëngjin:
 - Z. Izet SHAMETI përfaqësues i MZHETTS
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar“ Për Regjistrimin e Biznesit”, Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MILVA EKONOMI



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

URDHËR

Nr. 4098 Datë 20 / 4 /2017

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Z. Izet Shameti
2. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Znj. Orgita Milo, përfaqësuese e MZHETTS.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 14322

16.10.2017

URDHËR

Nr. ___ Datë ___ / ___ /2017

PËR

RI KONFIRMIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare”, i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 “ Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Ri konfirmimin në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në “Porti Detar” sha Shëngjin:
 - Znj. Mimoza Dhëmbi
2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar“ Për Regjistrimin e Biznesit”, Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

13510/1

411017.

URDHËR

Nr. ¹⁰⁴ Datë 4/10/2017

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Znj. Orgita Milo
2. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Z. Gledian Llatja, përfaqësues i MIE.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANÇAVE
DHE EKONOMISË
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

URDHËR

Nr. 146 / 2410 / 2017
Datë / / 2017

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirim nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Z. Emiliano Aleksi
2. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Z. Arbër Lleshi, përfaqësues i MFE-së.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

URDHËR

23.1.18

Nr 22 Datë 23/1/2018

184661,

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirim nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Z. Gledian Llatja
2. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Znj. Lindita Sotiri, përfaqësues i MIE-s.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



- Juristi
- Financa

24.01.2018

Protokollet



nr. 98. prot
dt. 25.04.19.

Nr. 7457 Prot.

Tiranë, më 24.4.2019

VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Nr. 145 Datë 24 / 4 /2019

PËR

NDYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 570, datë 03.10.2018 " Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Porti Detar" sha Shëngjin;

VENDOSA

- Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Z. Arbër Lleshi
- Emërimin në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në "Porti Detar" sha Shëngjin:
 - Znj.Violeta Shqalsi, Përfaqësues i MFE-së
- Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi filiestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



- Finance
- Juristi

Shëruar me origjinale



Protokol



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 15735/1 Prot.

Tiranë, më 22.8, 2019

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 87 Datë 22-8-2019

PËR

LIRIM ADMINISTRATORI

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 Nr. 7926, datë 20.4.1995 "Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në shoqëri tregtare" të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe statutit të shoqërisë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Porti Detar" sha Shëngjin, referuar dorëheqjes së depozituar me Nr. 15 135, datë 15.8.2019;

VENDOSA:

1. Lirimin e Z. Ermal Pacaj, nga detyra e Administratorit të shoqërisë "Porti Detar" sha Shëngjin Lezhë.
2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar "Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrë.
4. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



nr. 197 prot
dt. 11.09.19



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHETËTËRORE

Nr. 15135/2 Prot.

Tiranë, më 11.9.2019

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 87/11 Datë 11.9.19

PËR

EMËRIM ADMINISTRATORI

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 Nr. 7926, datë 20.4.1995 "Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në shoqëri tregtare" të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe statutit të shoqërisë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Porti Detar" sha Shëngjin;

VENDOSA:

1. Emërimin e Z. Gjergji Prendi, në detyrën e Administratorit të shoqërisë "Porti Detar" sha Shëngjin Lezhë.
2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar "Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.
4. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Chesuar me origjinalin.